



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:116138

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05730282

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.382/23

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të pandehurit B. G., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.844/23 të datës 23.05.2023 për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, supstancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 08.05.2024 në prezencë të prokurores së shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi, dhe të pandehurit B. G., të njëjtën ditë shpalli, ndërsa me datë 24.05.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri :

B. G., i biri i dhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt....., ne fsh.Lutogllavë, Komuna Pejë, ku dhe banon rr....., student, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar i njohur me lnj.nr....., shqiptar, shtetas i R. se Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me dt. 28.04.2023, rreth orës 04:00 të mëngjesit, në fsh. T. K.Pejë, pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope ose analoge me sasi prej 11,5 gram, në atë mënyrë që gjersa zyrtaret policor ishin duke patrulluar në vendin e lartcekur aty ndalojnë veturën e tipit A.A8 të cilën e drejtonte dëshmitari G. M., ndërsa në cilësinë e pasagjerit ishte i pandehuri B. G. dhe gjatë kontrolles të të pandehurit në gjepin e xhaketës i gjejnë një qese plastmasi-ngjyrë të zezë me substancë narkotike, ashtu që pas kryerjes së analizës së narkotikut ka rezultuar se substanca e dyshuar është e llojit Marihuanë me peshë neto prej 11.5 gram,

- me këtë ka kryer vepër penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 43, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit B. G. i shqipton:

- I. DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, të cilin detyrohet ta paguaj i pandehuri në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast që i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.
- II. DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse brenda periudhës prej 2 (dy) vitesh i pandehuri nuk do të kryej vepër tjetër penale, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej nga 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.
- IV. Substanca narkotike e gjetur te i pandehuri konfiskohet.

ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 23.05.2023 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën nën shenjë PP/II.nr.844/23, kundër të pandehurit B. G. për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 08.05.2024 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurorja e shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi, dhe i pandehuri B. G., në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurores së shtetit dhe në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së, gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Ne lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurorja e shtetit deklaroi “Pasi i pandehuri e pranoi fajësinë, e ky pranimi fajësie gjenë mbështetje në prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës unë mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik dhe i propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënoj si pas ligjit, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese”.

Pas aprovimit të pranimi të fajësisë nga ana e gjykatës, i pandehuri B. G. deklaroi “ I kërkoj falje gjykatës dhe Prokurorisë, jam pendu për veprën që e kam bërë dhe premtoj se nuk do të përsëritet ma kur”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40,42, 43, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tri (3) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro të cilin detyrohet ta paguaj i pandehuri në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda

periudhës verifikuese prej dy (2) vitesh, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar se i njëjti nuk ka ra ndesh me ligjin si dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi qe ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dënimi me gjobë;

Gjykata në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka vendosur qe ndaj të pandehurit të shqiptoj edhe dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, të cilin dënim detyrohet ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast qe i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

Dënimin më gjobë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për vepër penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit te dënimit me gjobë dhe me burgim në mënyrë kumulative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së vendosi qe të pandehurit t'i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim se bashku me dënimin me burgim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit te dënimit me burgim gjykata u bazua ne nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit B. G. do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi qe ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit. Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej dy (2) vite do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz qe të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet

“Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua më lartë për veprën penale që është shpallur fajtor i pandehuri është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tri (3) vjet.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit B. G. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike e cila ka qenë objekt i kryerjes së kësaj vepre penale, u morr në kuptim të nenit 269 par. 3 të KPRK-së e lidhur me nenin 276 par. 1 dhe 2 nën par. 2.4 të KPPRK-së.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.382/23, me datë 24.05.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale:

Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.